



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2022:000646

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05562771

C.nr.388/2021

GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Artan Abazi, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. V. nga, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Faruk Brestovci, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Ranillukut, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve për ushqim, me vlerë të kontestit 1,484.00 €, jashtë seance, me datë 11.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZHET në tëresi si e pabazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit B. V. nga me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Ranillukut, që paditësit t’ia paguaj kompensimin në emër të shpenzimeve për ushqim në shumë prej 1,484.00 €, edhe atë për periudhën kohore prej datës 01.01.2018, e deri më datën 01.04.2021, edhe atë nga 2 €, për çdo ditë pune, duke i llogaritur me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, aq sa dalin sipas llogarisë përfundimtare të shpenzimeve, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të aktgjykimit nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m i

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datën 28.12.2021, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Ranillukut, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve për ushqim, me vlerë të kontestit 1,484.00 €.

Në padi ka theksuar se paditësja ka themeluar marrëdhënie të rregullt të punës në kohë të pacaktuar në Departamentin e Administratës, në pozitën pylltar.

Përfaqësuesi i paditësit ka kërkuar nga e paditura kompensimin për ushqimin ditor për ditët e pranisë në punë, shumë prej 1,484.00 euro, edhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2018 deri më datë 01.04.2021, edhe atë nga 2 €, në çdo ditë pune, duke i llogaritur me

kamatë ligjore prej 8%, të paraparë si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në përmbushjen definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, aq sa dalin sipas llogarisë përfundimtare të shpenzimeve, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi të datës 10.11.2023, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses pasi që kontratën të cilën e bazon paditësi nuk prodhon efekte juridike dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Ranillukut, si e paditur. Për më tepër ka theksuar se e dispozita të cilës i referohet paditësja, se është obligim i punëdhënësit t'i paguaj shpenzimet e ushqimit në shumë prej 2 € në ditë, përkatësisht Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e datës 01.01.2015 nuk është në fuqi sepse e njëjta është zbatuar deri më datë 31.12.2017 ngase e njëjta është nxjerr për tri vite. Po ashtu ka theksuar se kërkesa e palës paditëse është parashkruar sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e cila ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015, e cila tani nuk është në fuqi dhe se nuk është vazhduar edhe për një vit e që tani nuk është në fuqi dhe nuk prodhon efekt juridik e as të drejta dhe detyrime, veçanërisht jo për periudhën për të cilën paditësi e kërkon pagesën.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike se paditësi është në marrëdhënie pune të e paditura, mirëpo kontestuese është se a i takon paditësit kompensimi për shujtën ditore, si dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata, për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike kontestimore i mori për bazë këto prova materiale, edhe atë: Akt emërimin me nr. 01-823/2016 e dt 30.12.2016.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e provës, komfor dispozitës së nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK-së), erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është parashkruar, rrjedhimisht është paraqitur pas kalimit të afatit 3vjeçar, këtë duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, si dhe Mendimit Juridik nr.40/2023 të dt.27.02.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, në pikën dy citohet se ..."*Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës aplikohet për periudhën kohore nga data 01.01.2015 deri më datë 31.12.2017*", e që paditësi padinë në gjykatë e ka paraqitur me datë 28.12.2021, pas kalimit të afatit 3 vjeçar, dmth prej datës 31.12.2017. Po ashtu gjykata nga njoftimi me nr. 392 i datës 15.09.2017 i lëshuar nga Oda Ekonomike e Kosovës drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, vërtetoi faktin se, Oda Ekonomike e Kosovës për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i MPKK tre muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj duke u bazuar në nenin 81 pika 1 të MPKK, Marrëveshja e përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe kohëzgjatja e saj është jo më shumë se tri vite, bazuar në Ligjin e punës neni 90 pika 4.

Gjykata nuk pati prova tjera materiale për të shtjelluar, mirëpo edhe po të kishte të njëjtat nuk do ishin me ndikim në vendosje ndryshe, ngase palës paditëse edhe ashtu i mungon baza juridike respektivisht kontrata kolektive e cekur si më lartë tani më edhe nuk është në fuqi, posaçërisht e njëjta nuk ka qenë në fuqi për periudhën brenda të cilës paditësi e kërkon kompenzimin e shpenzimeve të ushqimit ditor në punë.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 399 parag.1 dhe 2 të LPK-së, me të cilin përcaktohet se *“1. Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. 2. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*, e nga ky dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, mirëpo është kontestuese baza juridike.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së, si dhe duke pasur parasysh faktin se paditësi nuk ka pasur sukses në këtë çështje juridike kontestimore.

Duke u bazuar nga të lartcekurat, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.388/2021, më datë 11.04.2024

Gjyqtari,
Artan Abazi d,v

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.